



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE SIGURISË
PUBLIKE

Nr. 179/1 prot.

Tiranë, më 16.01.2026

Lënda: Dhënie mendimi mbi një projektvendim

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 5616/17 prot., datë 15.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 179 prot., datë 16.01.2026, me anë të të cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për miratimin e Planit të Veprimit Schengen 2026-2030” (në vijim “projektvendimi”), si dhe relacionin shoqërues.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së materialeve të dërguara, me qëllim që ky projektvendim të jetë në të njëjtën linjë me legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së të dhënave personale, vlerësojmë nevojën e disa saktësimeve, të cilat i dërgojmë, si më poshtë vijon:

Në kapitullin 8 “Mbrojtja e të dhënave në lidhje me kuadrin e Schengenit” të draft-planit të Veprimit Schengen 2026-2030, sugjerojmë që, pesë paragrafët hyrës lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të riformulohen me përmbajtje, si vijon:

“Mbrojtja e të dhënave personale parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shqipëria ka ratifikuar me ligjin nr.49/2022 “Protokollin ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”” (njohur ndryshe si Konventa 108+). Legjislacioni kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri përbëhet nga ligji nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale, i përafëruar me Rregulloren e Përgjithshme 2016/679 të BE për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) dhe Direktivën e BE 2016/680 “Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”, dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

Lidhur me kuadrin institucional, kapacitetet e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe ato të kontrolluesve publikë dhe privatë të të dhënave duhet të forcohen për të siguruar zbatim efektiv të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave, duke përfshirë edhe nismat e ndërgjegjësimit publik për kontrolluesit publikë dhe privatë të të dhënave personale.

Procedura për ushtrimin e të drejtës për informim dhe akses në të dhënat personale kryhet sipas parashikimeve ligjore (nenet 13 dhe 14 të ligjit nr. 124/2024) dhe për moszbatimin e tyre parashikohen përgjegjësi administrative për kontrolluesin sipas ligjit të sipërcituar . Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave personale ka rol të veçantë sipas nenit 34 të ligjit.

Në rubrikën “aktiviteti”, të pikës 8.1.2.2 të draft-planit të Veprimit Schengen 2026-2030, sugjerojmë riformulimin, me këtë përmbajtje: “Forcim i veprimtarisë mbikëqyrëse ndaj kontrolluesve/përpunuesve për garantimin e sigurisë teknike dhe konfidencialitetit, gjatë përpunimit të të dhënave personale”.

Sa më sipër, me reflektimin e propozimeve të sipërpërmendura, projektvendimi vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi